



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E SEKRETARIT TË KZAZ NR. 43, ANËTARIT TË KZAZ NR. 43,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 00.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për lirimin dhe emërimin e sekretarit të KZAZ nr. 43, anëtarit të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 21, pika 11, neni 29, pika 5, neni 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partia politike,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë me shkresën nr. prot. 13005, datë 29.06.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

Lirimin e anëtarit të KZAZ nr. 43, z. Elton Sula, dhe emërimin në vend të tij të znj. Valmira Troka; lirim e sekretarit të KZAZ nr. 43, z. Skënder Deda dhe emërimin në pozicionin e sekretarit të KZAZ nr. 43 të z. Elton Sula.



**Nr. 935 i Vendimit Data 29.04.2019 e Vendimit Ora 23:00 e Vendimit**

Për lirimin dhe emërimin e sekretarit të KZAZ nr. 43, anëtarit të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për propozimet për anëtar dhe sekretar të KZAZ-sw nr. 43, i gjen ato në përputhje me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 11, nenin 29, pika 5, nenin 32, pika 1 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 43, z. Elton Sula, dhe tw emërojw anwtare tw KZAZ nr. 43 znj. Valmira Troka.
2. Të lirojë nga detyra sekretarin e KZAZ nr. 43, z. Skënder Deda dhe tw emërojw sekretar të KZAZ nr. 43. z. Elton Sula.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 935 i Vendimit    Data 29.04.2019 e Vendimit    Ora 23:00 e Vendimit**

Për lirim dhe emërimin e sekretarit të KZAZ nr. 43, anëtarit të KZAZ nr. 43, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019